



Planuar / Dërguar Punimet/Prodato Received/Delivry	18-05-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	2911/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.251/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.251/2022 të datës 21.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga

kundër organit të punësimit Agjencia për Informim dhe Privatësi, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.251/2022 e datës 21.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.02/2022 i datës 14.03.2022, i Njësisë së Burimeve Njerëzore .

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi, me njoftimin e datës 25.01.2022 ka shpallur konkursin e datës 24.02.2022 me numër të referencës RN00008191 për vendin e punës “Drejtore i Përgjithshëm (1)”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Sipas vendimit me numër 02/2022 të datës 14.03.2022 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, ankuesit iu është refuzuar aplikacioni me kodin me numër RAN0003119 të datës 25.02.2022. Ankuesi i pa kënaqur më këtë vendim me datë 15.03.2022 parashtron ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi me datë 16.03.2022 merr vendim me numër 02/01/2022 me të cilin vendim e refuzon si të pa bazuar ankesën e datës 15.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

Ankuesi i pakënaqur me Vendimet e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi me datë 21.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 251/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi. Ndërsa me datë 04.04.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e nxjerrjes së vendimit meritore në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 21.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 16.03.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Konkursi i datës 24.02.2022; Informatat e aplikacionit me numër të referencës RN 00008191 e datës 14.03.2022; Vendimi i datës 14.03.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 15.08.2013 i lëshuar nga Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së; Akt emërimi i ankuesit i datës 02.07.2019; Vendimi i datës 15.08.2013 për caktimin e ushtruesit të detyrës e lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së; Aktvendimi me numër KI217/19 i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës; Diploma e datës 12.07.2011; Diploma e studimeve mastër e datës 24.01.2017; e-mail i datës 21.03.2022; Aplikacioni i _____ ne përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës; Lista e pikantëve; Lista e kandidatëve të pranuar; Ankesa e ankuesit e datës 15.03.2022 e parashtruar në Njësinë e Burimeve Njerëzore si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pa bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se Agjencia për Informim dhe Privatësi sipas njoftimit të datës 25.01.2022 ka shpallur konkursin publik me afatin për aplikim nga data 24.02.2022 deri më 03.03.2022 me numër reference RN00008191 për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm (1)" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, bazuar në dispozitat e nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranim, Vlerësim dhe Disiplinë të Nivelit të Lartë Drejtues.

Sipas njoftimit të konkursi të datës 25.01.2022 me afatin për aplikim nga data 24.02.2022 deri më 03.03.2022 me numër reference RN00008191 për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare: Fakulteti Juridik, Ekonomik apo Administratë Publike, me të paktën 240 kredi/ETC apo ekuivalente me to;*
- *Kualifikime të posaçme formale: nuk ka kërkesa të posaçme formale për këtë pozitë;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë, ne mesin e tyre edhe ankuesi i cili për këtë pozitë të punës, ka aplikuar me datë 25.02.2022 me numër reference RAN0003119, ndërsa me datë 14.03.2022 Njësia e Burimeve Njerëzore ka nxjerrë vendimin me Nr.02/2022 me të cilin ka refuzuar aplikacionin e i cili nuk kualifikohet për procedurat e mëtejme të rekrutimit sepse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 40 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 dhe 5.2 si dhe paragrafi 6 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“5. Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza: 5.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit, dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e Pranimit, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese”.*

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit lidhur me atë se ai i ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit, të datës 24.02.2022, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nëpërmjet përgjigjes në ankesë dhe provave shtese nga Agjencina për Informim dhe Privatësi të datës 04.05.2022, 11.05.2022, 18.05.20122 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dëshmohet se ankuesi nuk ka bashkëngjitur apo nuk ka përcjellë dokumentacionet e nevojshme të përgatitjes profesionale dhe përvojës së tij të punës, se bashku me aplikacion e dorëzuar me datë 25.02.2022 përmes SIMBNJ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili e konteston vendimin me numër 02/2022 të datës 14.03.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore për refuzimin e aplikacionit me kodin e aplikimit RAN0003119 për pozitën *“Drejtor i Përgjithshëm”* në Agjencinë për Informim dhe Privatësi me arsyetimin se i plotëson kushtet e konkursit dhe kërkon që të përfshihet në listën e ngushtë për testim me shkrim sepse i ka kredit e kërkuara sipas konkursit. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse sipas nenit 40 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 5 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore janë paraparë edhe kërkesat e përgjithshme formale të konkursit të publikuar dhe mbi bazë të provave që kemi administruar me rastin e kësaj ankese të dorëzuar nga palët konstatohet se i njëjti përkundër që aludon në shkelje të dispozitave ligjore të shërbimit civil konteston edhe aplikimin e dispozitave materiale që janë aplikuar me rastin e përjashtimit nga procesi i mëtutjeshëm konkurrues sipas këtij konkursi, dhe me faktin që nuk ka hyrë në listë të ngushtë dhe se i është refuzuar ankesa për vazhdim të procedurës së rekrutimit për pozitën *“Drejtor i Përgjithshëm”*, ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet formalo-juridike të konkursit nga se i njëjti me rastin e aplikimit ka bashkëngjitur Diplomën me numër 1167 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik me të cilën dëshmohet se ankuesi me datën 10.02.2007 ka përfunduar studimet themelore universitare dhe ka marr titullin Bachelor i Drejtësisë me gjithsej 180 pikë/ECTS, po ashtu ka bashkëngjitur Diplomën me numër 1298 të datës 24.01.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës *“Hasan Prishtina”* me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet mastër më 12.12.2016 në Fakultetin Juridik, Drejtimi Kushtetues-Administrativ, si dhe më përvojë pune si në vijmë: sipas Vërtetimit të lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vërtetohet se ka qenë i angazhuar në vendin e punës *“Koordinator i Terrenit”* në zgjedhje të jashtëzakonshme në periudhën shtator-dhjetor 2007; po ashtu nga data 24.05.2011 deri me date 01.09.2020 në vendin e

punës "Zyrtar i Lartë i Shërbimit të Votuesve sipas Akt Emërimit me numër 34/2011 të datës 24.05.2011; nga data 01.09.2020 deri me date 12.07.2021 në vendin e punës "Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në SKQZ" sipas Akt Emërimit Form.KQZ-R-12 të datës 01.09.2020; si dhe nga data 12.07.2021 - vazhdon në vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin me Votues" në Komisionin Qendror Zgjedhor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se sipas dëshmime të ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, në dosje të ankuesit kanë qenë të bashkëngjitura dëshmitë mbi përvojën e punës si ne vijim: Vërtetimin e lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas të cilit dëshmohet se ankuesi ka qenë i angazhuar në vendin e punës "Koordinator i Terrenit" në zgjedhje të jashtëzakonshme në periudhën shtator-dhjetor 2007; Vërtetimin e lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë e datës 07.09.2007 sipas të cilit dëshmohet se ankuesi ka kryer praktiken vullunetere në Gjykatën Komunale në Prishtinë nga data 04.09.2006 deri me date 04.09.2007; Akt Emërimit me numër 34/2011 të datës 24.05.2011 sipas të cilit dëshmohet se ankuesi ka punuar në vendin e punës "Zyrtar i Lartë i Shërbimit të Votuesve nga data 23.05.2011; Akt Emërimit me numër protokoll 687-2019 të datës 02.07.2019 sipas të cilit dëshmohet se ankuesi ka punuar në vendin e punës „Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin me Votues" nga data 02.07.2019; Akt Emërimit me numër Form.KQZ-R-12 të datës 01.09.2020. sipas të cilit dëshmohet se ankuesi ka punuar në vendin e punës "Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në SKQZ" nga data 01.09.2020 deri me date 12.07.2021; Vendimin me numër protokoll 1800-2021 të datës 12.07.2021 të lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas të cilit dëshmohet se ankuesi ka punuar në vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin me Votues" nga data 12.07.2021 dhe ende vazhdon në Komisionin Qendror Zgjedhor.

Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të këtyre dokumenteve të ofruara ka konstatuar se ankuesi nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës në pozita drejtuese pas diplomimit prej pesë (5) viteve ashtu siç është kërkuar në konkurs dhe se Njesia e Burimeve Njerezore, me rastin e mospërfshirjes së ankuesit në listën e shkurtë, ka vepruar në pajtim me nenin 8 paragrafin 1, 2, 3, dhe 4 të Rregullores (QRK) – Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtuese, ku përcaktohet se: „Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlihen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme; Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e fundit e pranimit të aplikacioneve.”

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi, me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dorëzuar edhe dëshmi tjera për përvojën e punës, mirëpo të njëjtat nuk i ka dorëzuar me rastin e aplikimit për pozitën, "Drejtor i Përgjithshëm (1) të shpallur sipas konkursit të datës 24.02.2022, me numër të referencës RN00008191 nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues,

edhe pse ne bazë te dëshmimeve te ofruara nga organi i punësimit, Kolegji ka konstatuar se Menaxherja e Burimeve Njerëzore me 02.03.2022 përmes e-mailit e ka njoftuar kandidatin se me aplikacionin e pranuar nuk janë bashkangjitur dokumentet te cilat nevojiten për te dëshmuar se i plotëson kriteret e konkursit dhe ka kërkuar nga ankuesi që ti sjellë dokumentet që mungojnë ne afatin e caktuar.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar ne faktet e lartcekura konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e nxjerrjes së vendimit Nr.02/2022 të datës 14.03.2022 ka vepruar drejtë duke u bazuar në dispozitat e nenit 40 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 8 paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues sepse ne rastin konkret Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale sipas konkursit të datës 24.02.2022.

Bazuar në legjislacionin në fuqi të Shërbimit Civil dhe mbi këtë bazë ligjore të specifikuar më lartë vendimi i Njesisë së Burimeve Njerëzore Nr.02/2022 i datës 14.03.2022 është nxjerrë në harmoni me legjislacionin në fuqi të zyrtarëve publik, andaj pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.251/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.